



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Ministarstvo Sredine i Prostornog  
Planiranja-Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

<b>DATË/A:</b>	29.09.2015
<b>REFERENC-Ë:</b>	ZSP - 1216/15
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Komunën e Prishtinës
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së <i>Alt</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shqyrtimi i kërkesës nga Komuna e Prishtinës për Taksat për Leje të Ndërtimit për vitin 2016 me Nr.Protokolli 4116/15 të datës 13.08.2015

Të nderuar,

Bazuar në shkresën e datës 13.08.2015 me numër protokolli 4116/15, lidhur me caktimin e taksave për leje ndërtimore nga Komuna e Prishtinës (tutje si: Komuna), MMPH ka shqyrtuar dhe analizuar shkresën se bashku me dokumentacionin përcjellës dhe konstaton si në vijim:

Komuna ka propozuar Taksën Administrative të lejes ndërtimore për vitin 2016 në pajtim me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012 për Lëshimin e Lejes së Ndërtimit dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës.

Taksa Administrative për Lëshimin e Lejes së ndërtimit e llogaritur nga Komuna është **6.50 €/m<sup>2</sup>** ( gjashte euro e pesëdhjete cent për metër katror).

Tarifa për rritjen e densitetit të infrastrukturës është llogaritur konform Shtojcës 3 të UA Nr.22/2012, dhe kjo Tarifë duhet të llogaritet vetëm për njësit e reja të banimit, konform formulës së përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1 i UA nr.22/2012.

Komuna duhet të procedoj për aprovim taksat për lëshimin e lejes së ndërtimit në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110.

Me respekt.

Faqe 1 nga 1